

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE**  
**“CONFINLOCA ” SH.P.K**  
**ME SELI NË DURRËS**

Sot, më datë 19.11.2024 (dymijë e njëzetekater), ortaku:

Zj **Alessandra Morena**, atesia Benito Morena, memesia Bocchetti Maria, e lindur më 14/12/1974 ne Campobasso, Itali banues në MONTESILVANO (PE) VIA G. CHIARINI 22, Itali , madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me leternjoftim italian nr CA22011AV.

Për të cilin u përpilua e kjo kontrate themelimi e shoqërisë tregtare **CONFINLOCA SH.P.K**, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Shoqëria Tregtare **CONFINLOCA SH.P.K**, është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

**NENI 2**

**Emri i shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **CONFINLOCA SH.P.K**

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë shtrihet në fushat e mëposhtme:

Veprimtaria e Shoqërisë **CONFINLOCA SH.P.K** do të ketë për objekt:

Konsulence dhe shërbime për shoqëritë, firmat, enteve private dhe të tjere profesionale. Kërkim tregu, sondazhe në marrjen e opinionëve, shërbime informatike, bashkëpunim në blerjen e të dhenave të çfaredo lloji, për llogari të të tjerëve. Konsulence investimesh financiare. Konsulence imobiliare në sektorin e pasurive të paluajtshme , menaxhimi i godinave dhe të strukturave sportive, rikrijuese për aktivitetet kulturore të kohës së lire. Planifikimi i territorit, planifikimi urban, konsulence teknike industriale-dizajn, arkitekturë, projekte civile dhe industriale, inxhinierike, dizajne teknike, projektme dhe grafikë, konsulencë teknike, patentat dhe marka tregtare, konsulence për sistemet e cilësisë së kompanive dhe sistemet mjedisore, siguria në mjediset e punës, marketing, prodhim, shitje, reklama, marrëdhënie me publikun dhe grafikë të reklamave, organizimi i panairëve dhe ekspozitave, rregullimi dhe mobilimi i tyre. Konsulence dhe asistencë për trajnim staf, rekrutim, përzgjedhja dhe marrja në punë e stafit, planifikimi, organizimi dhe menaxhimi i kurseve për aktivitetet e lartpermendura , përfshirë mësimdhënia, promovimi dhe organizimi i kurseve edukimit, ngjarje të

të gjitha llojet dhe emisionet e një reklamative, promocionale, sportive, muzikore, kulturore dhe shoqërore, si publike dhe private. Kompania ka edhe si qëllim, shitje online shumicë dhe pakicë të makinave, motocikletave, karavanëve, kamionëve dhe pjesëve këmbimi - makina me qira me shofer. Objekti i shoqërisë përfshin edhe ndermjetesimin e pasurive të paluajtshme, letra me vlerë, ndërmjetësim industriale, tregtare, financiare të lejuara nga ligji për të cilën shoqëria do të pajiset me autorizimet e posaçme sipas kërkesave ligjore.

Shoqëria do të ketë si objekt menaxhimin, blerjen, shitjen, të tokave dhe ndërtesave me qëllim restaurimin dhe rishtijen e tyre, për llogari të tijen dhe për të treta. Aktivitetet e sistemeve dhe menaxhimi i bareve, restoranteve, picerive, pasticerive, hoteleve, sallave të kercimit, bujtina, kamping, objektet e plazhit, mensat e kompanisë dhe gjithçka tjetër lidhur me administrimin e ushqimit dhe pijeve, të gjitha në zbatim të ligjeve të miratuara me Ligj, për të përmbushur objektin e shoqërisë. Kompania do të mund të blejë, të shesë, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, dhenien me qera dhe menaxhimi i kontratave, prokurimi, marrja e investimeve dhe interesave në kompanitë ose biznese të tjera me të cilat shoqëria ka marrëveshje të lidhura në mënyrë direkte ose indirekte duke vendosur kështu apo formë të tjera financimi, duke dhënë mundësi garancie të pasurisë së paluajtshme edhe për llogari të treta, përfshirë leshimin e garancive për detyrimet e veta dhe të tretëve. Kompania gjithashtu mund të marrë pjesë në themelimin ose bashkimin me përthithje të kompanive, me përjashtim të aktivitetit të mbledhjes së kursimit nga publiku.

Objekti i shoqërisë është aktiviteti i shërbimeve konsulences dhe formimi i shoqërive të cilat bashkon në një strukturë të vetme sektore të ndryshme ku organizimi është themelor, që synon krijimin e një serie shërbimeve për biznese, kompani, ente private dhe të tjera profesionale; studimi i tregut, sondazhet dhe opinione, shërbime informatike, në perpunimin e të dhënave për vete dhe për të treta.

Konsulencë në fushën e investimeve financiare të lejuara nga legjislacioni shqiptar për të cilën shoqëria do të jetë e pajisur me autorizimet e posaçme të kërkuara nga ligji.

Objekti i shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të pakesohet në bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.

#### **NENI 4**

##### **Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Qytetin e Durrësit, në adresën: Lagja 17, Rruga Neki Libohova, objekt me nr. pasurie 2/1029+2-39, ZK. 8513 Durrës, Durrës.

#### **NENI 5**

##### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 1 000 000 leke, e ndarë në 1 kuotë. Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë të ndara si më poshtë:

- 1. Zj Alessandra Morena** në cilësinë e ortakut themelues zotëron 100% të vlerës së kuotave në kapitalin themeltar ose 1 kuotë të barabarta me vlerë prej 1 000 000 Leke në kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortaku Themelues në rast të miratimit të kësaj kontrate themelimi dhe të firmosur nga ai.



## **NENI 6**

### **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktiviteti fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve.

## **NENI 7**

### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët zgjidhen për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

**Administratori i Shoqërisë do të jetë Zj Alessandra Morena**, atesia Benito Morena, memesia Bocchetti Maria, e lindur më 14/12/1974 ne Campobasso, Itali banues në MONTESILVANO (PE) VIA G. CHIARINI 22, Itali , madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me leternjoftim italian nr CA22011AV.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

## **NENI 8**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

## **NENI 9**

Ortaku detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për demet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

## **NENI 10**

### **Ligji i aplikueshëm**

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortaku themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 11**

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

**NENI 12**

**Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe italiane dhe u lexua dhe firmos me vullnet të lirë nga Ortaku Themelues.

**ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOQËRISË**

**CONFINLOCA SH.P.K**

**ALESSANDRA MORENA**

ALESSANDRA MORENA

